



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 24 shtator 2021, në mbledhjen e XL-të (dyzet) mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhes, dhe filloi në orën 10;15

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Rafet Llapashtica, Endritë Murati, Patriot Rudari.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, Fevzi Jetullahu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, Bujar Hasani, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, Bahri Selimi, drejtor i Drejtorisë së Administratës-DA.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar dhe përshëndetur të pranishmit, theksoi, nëse dikush ka diçka për të shtuar urdhëroni, nëse nuk ka e vë në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA-së, theksoi, në mungesë të drejtorit të DPUMM, po e paraqes një kërkesë për një pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës, fjala është për propozim vendimin për vënien në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale për të cilin material e paskan sjell me vete nga Drejtoria dhe që tani ju shpërnda, andaj kërkohet të shikoni mundësin e futjes në rend dite për këtë seancë dhe pastaj të shqyrtohet kjo çështje për t'i rekomanduar Kuvendit si pikë shtesë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë tani erdhi drejtori i DPUMM, kërkoj ta merr fjalën dhe ta jap një arsytim të shkurtër lidhur me këtë propozim për vendosjen si pikë shtesë në rendin e ditës për këtë seancë.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM-së, theksoi, së pari ju kërkojmë falje që erdhi kaq me vonesë kjo kërkesë mirëpo për shkak të nevojës dhe konsultimeve me Ministrinë përkatëse edhe u bënë këto vonesa. Kërkesë e jona për konsultim paraprak ishte që për këtë propozim të na kthehej një konfirmim se gjithçka është në rregull dhe si e tillë dokumenti në fjalë mund të procedohet për Kuvend, por për vonesat e tyre jemi deri në këtë pikë.

Ky propozim vendim është i njëjti me atë që e kemi shqyrtuar dhe miratuar më herët (para dy seancave) por për shkak se ai vendim na është anuluar ligjërisht nga Ministria sepse fillimisht na kanë orientuar gabimisht, do të thotë kemi bërë gabim në hapa njëfarë mënyre, dhe tani pas vendimit të fundit të Kuvendit që është marr për të bërë ndryshim plotësimet e nevojshme të projekt Hartës Zonale, kërkohet

që të vëhet në shqyrtim publik, do të thotë se për t'i bërë ndryshimet dhe plotësimet në projekt Hartën Zonale është e nevojshme edhe njëherë të merret një vendim për ta vendosur në shqyrtim publik, jo për 15 ditë, por për 30 ditë dhe kjo gjithësesi sipas kërkesave të Ministrisë përkatëse, prandaj kërkohet nga Kuvendi, respektivisht KPF që të hyjë si pikë shtesë në këtë rend të ditës dhe pastaj të diskutohet më gjerë dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të këtij propozim vendimi me të vetmin qëllim që dokumenti në fjalë të ecë përpara duke përfshirë ndryshimet dhe plotësimet që janë bërë, dhe natyrisht se do të ketë hapësira për ndryshime dhe plotësime edhe në të ardhmen gjatë shqyrtimit publik 30 ditor që do të mbahet.

z.Mehmet Gashi, theksoi, duke marr për bazë që është një material shumë i rëndësishëm dhe të them të drejtën unë nuk pata mundësi që për dy minuta ta lexoj pasi që është dokument shumë i rëndësishëm. Parimisht materialet duhet t'i kemi 7 ditë pune para seancës në mënyrë që ta kemi para vetës dhe të mund të analizojmë e që nuk do të kishte problem, por jo në këtë mënyrë ta sjellni këtë pikë kaq të rëndësishme, andaj të njëjtën unë jam për ta shtyrë për mbledhjen e radhës, kurdo që të thirret ajo mbledhje, qoftë edhe nëse thirret e jashtëzakonshme në mënyrë që t'i kemi materialet me kohë dhe të kemi mundësi ta lexojmë dhe përpunojnë, por jo të ndodh kështu vetëm të kërkohet të vendoset në rend të ditës pa ditur ne asgjë se çfarë ka të bëjë me këtë dokument.

Unë fola në emrin tim personal pa u konsultuar mirë me anëtarët tjerë të Grupit të LDK-së, mirëpo më duket se nuk është në rregull që aty për aty me sjell në mbledhje dhe me vendos në rend dite këtë pikë/material kaq të rëndësishëm.

z.Florent Hasani, theksoi, dike e ditur rendësin e ecjes para me këtë pikë për interesin e qytetarëve dhe duke e ditur që është përmbajtja e njëjtë sikurse në mbledhjet e kaluara, domethënë nuk ka ndryshuar asgjë dhe të njëjtin e kemi shtyrë bashkërisht si Kuvend herëve tjera, është paraqitur e njëjta vetëm se me kërkesën e Ministrisë përkatëse po kërkohet edhe njëherë të miratohet prej Kuvendit, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështet dhe është për shtyrjen përpara këtë pikë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM-së, theksoi, i referohem kolegut z.Mehmet Gashi, si material nuk ka ndryshuar në thelb nga materiali i mëparshëm dhe nuk është që duhet një analizë shumë e madhe.

Dua të them se me mirësjellje po ua kërkojmë që me ecë tutje dokumenti i Hartës Zonale duke përfshirë ndryshimet që i kemi propozuar, pra propozim vendimin e keni para vetës dhe varet nga ju se a do ta votoni apo jo, ndërsa nuk mund të themi se është një material krejt i pa njohur për ju ngase e kemi diskutuar këtë çështje shumë herë, dhe siç e thotë populli “është bërë bjeshkë”, prandaj edhe njëherë e them se është mirë të votohet sepse ka të bëjë vetëm me vënien në shqyrtim publik, jo për miratim final të ndonjë dokumenti ngase sërish do të sjellët në Kuvend për miratim final.

z.Mehmet Gashi, theksoi, për hir të dokumentacionit që është shumë i rëndësishëm, kërkoj pauzë 5 minuta me qëllim të konsultimeve mes vete ne si anëtar të grupit të këshilltarëve të LDK-së së bashku me ju drejtor i DPUMM.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM-së, theksoi, nëse e vlerësoni të nevojshme për sqarime shtesë nga ana ime mund edhe ta kemi një pauzë ashtu siç u propozua, nuk është telashe fare.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë shkojmë me 5 minuta pauzë.

Pauzë nga ora 10:25 deri 10:35 ku edhe vazhdon mbledhja

Kryesues i Komitetit, theksoi, pra është propozim i DPUMM-së që në rend të ditës të futet si pikë shtesë për të cilën edhe u jepen arsyetimet.

z.Mehmet Gashi, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së u konsultuam rreth kësaj kërkesë dhe në fillim unë isha kundër që çdo material të vij në këtë mënyrë, sidomos materialet që janë shumë të rëndësishme siç është kjo për projekt Hartën Zonale, prandaj pas konsultimit që patëm, ne vendosëm që të abstenojmë për këtë pikë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim kërkesën për pikë shtesë të rendit të ditës propozim vendimin për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit (pas konsultimit me zyrtarin e Ministrisë së Pushtetit Lokal i cili është i caktuar monitorues për Komunën e Podujevës), konstatoi se me 2 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 6 vota të Përmbajtura, mbështetet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje si pikë shtesë;
- Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, përkatësisht me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021. (dhe renditet në pikën 7 të rendit të ditës)

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e ditës në tërësi, përfshirë edhe pikën shtesë sipas konstatimit paraprak lidhur me propozimin e DPUMM.

Pas votimit u konstatua se me 5 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe 3 vota të PËRMBAJTURA, miratohet rendi i ditës, përfshirë edhe pikën shtesë që ishte kërkesë e Drejtorisë së planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së mjedisit, dhe atë;
- Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të projekt Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, përkatësisht me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021. (dhe renditet në pikën 7 të rendit të ditës)

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28 korrik 2021

Njëzëri miratohet sipas materialit përkatës

2. Propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, lidhur me miratimin e buxhetit për vitin 2022 që padyshim është një prej dokumenteve më të rëndësishme të cilin e aprovon asambleja komunale, i kemi ndjekur të gjitha procedurat duke përfshirë edhe diskutimet publike dhe kemi ardhur deri tek finalizimi i këtij projekt buxheti. Normalisht ashtu edhe siç dihet buxheti ndërtohet mbi bazën e Qarkoreve Buxhetore të cilat lëshohen nga Ministria e Financave. Lidhur me këtë ne veç kemi diskutuar kur ka qenë si pikë në rend të ditës Korniza Afatmesme Buxhetore, mirëpo normalisht në raport me Qarkoren e parë Buxhetore janë disa me Qarkoren e dytë ku ka një rritje tek subvencionet dhe tek mallrat.

Buxheti total është 24,449,521.00€ dhe normalisht sot nuk po dëshiroj lëshohem në detajizime rreth shumave në kategori, programe, nëpër Drejtori dhe çështje tjera të caktuara rreth projekteve, ngase besoj që materialin e keni marr me kohë dhe keni arritur ta shqyrtoni si dhe ndoshta keni mund ta vëreni që edhe tek kategoritë e mallrave edhe të shërbimeve janë të specifikuar të gjitha kategoritë se çfarë ka për

tu shpenzuar këto mjete buxhetore nëpër të gjitha programet të cilat janë. Ju ftoj që përveç rekomandimit për mbledhjen e asamblesë komunale, besojmë që edhe do të aprovohet ky buxhet për arsye se po e ndjejë si obligim ta them edhe në këtë mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, që mos aprovimi i këtij buxheti i sjell disa pasoja negative për funksionimin e Komunës së Podujevës, e vërteta është që mos miratimi i këtij buxheti dërgon deri tek miratimi i një buxheti nga ana e Ministrisë së Financave si një buxhet të përkohshëm i cili bazohet në buxhetin e vitit 2021 e që në fakt buxheti i vitit 2021 në momentin kur e aprovon Ministria e Financave është afërsisht 700,000.00€ më i vogël sesa buxheti i planifikuar për 2022 sipas Qarkores Buxhetore për vitin 2022, përkundër kësaj një pasoj tjetër tejet negative të cilën mund ta sjell mosmiratimi i këtij buxheti është se menjëherë neve na duhet ta kalojmë/miratojmë pastaj nga një asamble tjetër ngase nuk mbetet më kohë nga ana e kësaj asambleje aktuale që është. Pastaj pas miratimit nga asambleja e ardhshme projektbuxheti duhet të shkoj për miratim të veçantë në Parlamentin e Kosovës dhe në rast se nuk aprovohet ky buxhet është vështirë se do të kemi buxhet deri në muajin mars të vitit 2022 dhe në çoftë se shkon buxheti deri në atë kohë, i bie që ne nuk mund ta dërgojmë planin e prokurimit në KRPP dhe rrjedhimisht asnjë procedurë e prokurimit në Komunën e Podujevës nuk mund të zhvillohet pa aprovimin e buxhetit dhe pa aprovimin e planit të prokurimit, çështje për të cilën këtu e kemi edhe ish drejtorin e Drejtorisë së Financave edhe të Urbanizmit që ka qenë, dhe është në dijeni se të dyja këto mos fillime të procedurave që i ceka deri në muajin mars, domosdoshmërisht e dërgon në suficit buxhetor Komunën e Podujevës sepse për tu realizuar projektet duhet të fillojnë në muajin janar, kështu që po them se në çoftë se nuk aprovohet tani ky buxhet, Komuna e Podujevës në vitin 2022, varësisht se kush do të qeverisë do të përballlet patjetër me një suficit të theksuar buxhetor nga mos realizimi i projekteve që mund të ndodh, normale të shikohen pak më shumë ecuria e projekteve dhe duke i pasur parasysh kapacitetet administrative të Komunës së Podujevës, ndoshta mund të shkoj në suficit deri në 2 milion euro sa ishte vitin e kaluar por që arsyeja ka qenë pandemia dhe ka shkuar më enorm ndoshta se vitet tjera, prandaj me të njëjtin suficit buxhetor mund të ballafaqohet qeverisja e ardhshme në vitin 2022, kështu që ju rekomandoj që përveç që ta votoni dhe rekomandoni për shqyrtim në seancën e Kuvendit nga të gjitha Grupet parlamentare ta mbështetni këtë buxhet për të cilin jemi përpjekur ta bëjmë më të mirën, normal në bazë të limiteve buxhetore dhe kemi qenë të gatshëm të bashkëpunojmë me çdonjërin në mënyrë që të kemi një buxhet i cili pa dyshim se është i të gjithëve, i qytetarëve dhe i kujtdo që qeverisë sepse janë këto projekte të cilat kanë për t'i gëzuar qytetarët.

z.Mehmet Gashi, theksoi, i dëgjuam fjalët e drejtorit të DBF-së, dhe fillimisht na paraqiti edhe ato pasojat nëse nuk miratohet buxheti, mirëpo unë mendoj që nëse dështon buxheti nuk është faj i yni por faj i Ekzekutivit që vërejtjet që i kemi dhënë në Kornizën Afatmesme Buxhetore-KAB nuk janë marr për bazë dhe nuk është përmirësuar pothuajse asgjë. I kam shikuar projektet që kanë qenë në KAB dhe i kemi pasur disa vërejtje të cilat mendoj që janë vërejtje me vend por jo vetë ashtu sa për të bërë kritikë, e që unë në emër të Grupit në diskutimin time pata thënë që është e nevojshme që projektet të mos jenë të përgjithësuara, pra këtë e kam thënë çdo herë, madje edhe Grupi i këshilltarëve të LVV-së ka kërkuar që projektet të jenë të precizuara, emërtimi i projektit, rruga, dhe gjitha çështjet tjera të nevojshme, shembull, në urbanizëm thuhet asfaltimi i disa rrugëve në qytet, asfaltimi i disa rrugëve nëpër fshatra ose në disa fshatra, gjithashtu edhe tek kanalizimet e njëjta gjë, prandaj unë atëherë kur kam bërë vërejtjet, nga ana juaj është thënë se nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme, kurse tani nga ajo kohë prej atëherë është gati 2 muaj dhe nuk përmirësuar fare vërejtjet tona dhe nuk i keni marr për bazë fare, domethënë po shkoni me një rrezik që të mos miratohet buxheti në Kuvend.

Unë jam për, që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sepse nuk jemi që ta bllokojmë qysh sot në këtë Komitet, mirëpo ato vërejtje janë serioze dhe këtë e them duke u bazuar në atë që i kam lexuar dhe analizuar të gjitha projektet ku projekti i parë ose i dytë ndryshon vetëm tek shuma, të tjerat janë të përshtatshme siç kanë qenë dhe për këtë keni qenë në dijeni që nuk është miratuar KAB, çështje për të cilën

nuk po e fajësojë drejtorin e DBF sepse këtij ashtu siç i'a sjellin projektet ky i vendos, mirëpo nuk e kuptoj këtë sepse për disa vërejtje që kanë qenë është dashur të merren për bazë qoftë nga Kryetari i Komunës qoftë nga drejtorët e Drejtorive.

Po e marrë shembull, ka raste që pyetem në rrugë nga një palë i cili e thotë se që 30 vite nuk kemi një kanalizim në qytet, siç është rruga "Kongresi i Manastirit", dhe ai person ka qenë tek Kryetari për këtë çështje, mirëpo nuk jam i sigurt a po vendoset në projektbuxhet apo jo, prandaj nëse takohemi me atë person sërish, pyetja e tij e parë është se çfarë kanë bërë, a është futur në planifikime ai projekt apo, prandaj e them se projektet janë të përgjithësuara të gjitha pothuajse, e që për këtë çështje ju duhet ta llogaritni që jemi në zgjedhje dhe mund të ndërrohet pushteti, mirëpo ne nuk e dimë ku shkruan projekti juaj i paraparë në rast se miratohet ngase janë të përgjithësuara, do të thotë mbetet pothuajse vendim që duhet ta merr drejtori përkatës pastaj apo ndokush i cili mund t'iu thotë qytetarëve se NN projekti është paraparë dhe menduar për tek lagja apo fshati juaj, mirëpo atë projekt nuk po e planifikoni ashtu siç po kërkohet kur kemi parasysh se janë të emërtuara të gjitha rrugët e Komunës së Podujevës dhe është dashtë të specifikohen projektet, andaj çka është parë problem që të specifikohet rruga apo kanalizimi se ku do të ndërtohet (rr."Kongresi i Manastirit", gjatësia kaq) dhe do të ishte e përfunduar kjo çështje e që keni pasë kohë 2 muaj për përmirësimin e dokumenteve nga KAB, por nuk e keni bërë, andaj pavarësisht kësaj, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të projektbuxhetit të komunës për vitin 2022 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2023/2024, mirëpo kemi vërejtje serioze që nuk ka pasur kurrfarë përmirësimi nga ajo që është paraqitur në KAB, dokument ky i cili është hera e parë pas luftës që nuk miratohet nga Kuvendi i Komunës së Podujevës.

z.Florent Hasani, theksoi, edhe ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas kësaj pike të rendit të ditës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga PDK, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit në fjalë..

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, kur është pyetja tek specifikimi i projekteve, vitin e kaluar kur është miratuar propozim vendimi i buxhetit ka qenë çështja tek kategoria e mallrave ku janë 2,360,000.00€ dhe ashtu është votuar, tani që i keni të specifikuar në të gjitha Drejtoritë se për çka kanë për tu shpenzuar ato mallra, lëndë djegëse, shërbim kontraktues etj, sepse dihet çka janë shërbimet kontraktuese, a janë shpenzime të naftës apo të gjitha tjerat, do të thotë vitin e kaluar në këtë Kuvend është votuar buxheti me shumën 2,360,000.00€ në kategorinë e mallrave dhe ato mallra nuk kanë qenë të specifikuar dhe e gjithë ato kanë hyrë më vonë në sistemin DDMS dhe qysh do që ka dashur ai pastaj i ka vendosur ato të dhëna në DDMS.

Një çështje tjetër, tek investimet kapitale e kemi edhe drejtorin e DPUMM-së këtu, janë një pjesë e madhe e investimeve në zonën e qytetit, shembull ndërtimi i rrugëve "Skënderbeu", "Xhemajl Mustafa" dihet se cila është ajo rrugë pra, por ka edhe rrugë të tjera që janë të specifikuar, ta zëmë një çështje tjetër është ndërtimi i rrugëve në fshatin Llapashticë shuma 80,000.00€, pra ne për diçka jemi shumë të informuar që rrugët e mëdha të fshatrave janë asfaltuar dhe tani kanë mbetur rrugica, pastaj më duket se në kontratën për ndërtimin e rrugëve në fshatin Sekiraçë janë 15 rrugë me ato 40,000.00€ që janë ndërtuar.

Kemi edhe një çështje, një emërtim i një projekti nuk mund t'i bartë më shumë se 50 karaktere/shkronja-simbole dhe për t'i emërtuar ashtu siç duhet nevojitet gjysmë flete përshkrim sepse bëhet fjalë për rrugica shumë të vogla, mandej kemi ndërtimin e rrugëve me zhavorr ku ndoshta janë të shumta (unë e di që në këtë vit me këtë pozicion buxhetor është intervenuar në afër 100 rrugë) kurse me rritjen buxhetore për këtë pozicion do të ndërhyhet në 200 rrugë dhe nëse kërkohet specifikim i të gjitha këtyre 200 rrugëve nuk ekziston mundësia në program sepse në momentin kur kalohet numri prej 50 shkronjave nuk pranohet.

Pastaj tek sqarimet, kur jepet mundësia e sqarimeve se si duhet përshkruar projektin, normalisht që përshkruhet sepse nuk e pranon as Ministria e Financave pa përshkrim, mirëpo tani kur dikush dëshiron të

gjejë arsye edhe mund të gjejë arsye dhe këtë e them m bindje ngase ne të gjithë jemi këtu të emëruar politik, pas 1 muaji mund të jem ose të mos jem në këto pozita dhe nuk është problemi këtu ngase edhe qytetarët kanë për të votuar, por çështja është te dëmet financiare të cilat i ka Komuna e Podujevës dhe ato janë evidente, andaj nuk do të ishte mirë që votën tonë ne t'i shkaktojmë ato dëme, sepse besoj se nuk na ka ndonjë borxh qytetari. Ne si qeverisje e kemi trashëguar një buxhet nga qeverisja e kaluar, buxhet i miratuar nga kjo assemble komunale natyrisht, por e ka miratuar buxhetin e ish qeverisjes, çdo qeverisje e cila vije ta rrëzoj këtë buxhet dhe është në rregull, mirëpo kushdo që ka për të qeverisur dhe kushdo që është drejtor i DBF-së ndër të tjerë ka për t'u ballafaquar sepse deri në muajin prill ka vetëm për të ndejtë këtu dhe nuk ka për të kryer asnjë punë, vetëm ka me u merr me letra dhe takime nëpër Ministrinë e Financave, dhe në fund kemi me ardhur tek ai suficiti ku do të ketë afër 2 milion euro ngase nuk mundet askush ta kaloj atë. Edhe unë mund të gjejë arsye dhe mundem të mos e votoj buxhetin shembull, sepse gjithmonë ka vërejtje dhe gjithmonë ndoshta është shumë e debatueshme kjo çështje, por arsyeja e mos votimit mund të jetë thjesht politike, kushdo që nuk e voton dhe është në rregull sepse normale që nuk mund të interferojmë te çdo njëri, mirëpo është shumë e dobishme dhe në interes të qytetarëve që kjo çështje të diskutohet dhe arsyet janë vetëm politike.

znj. Fatlume Jaha, theksoi, nuk e pata ndërmend të marrë fjalën, por u detyrova prej fjalëve të drejtorit të DBF-së, dhe tani kam një kritikë shumë sinqerisht që t'ju jap projekteve specififikimet e rrugëve që u përmenden dhe për çka u tha se ka probleme. Unë kam përshtypjen që politikisht jeni të angazhuar edhe më herët, por kisha dashur sinqerisht t'ju pyes drejtor se a ke dalë para datës 29 nëntor 2020 dhe t'ju sqarosh edhe kolegëve tuaj në parti, për këtë defekt, sepse gjithë kohës të paktën prej kur unë jam pjesë e Kuvendit vazhdimisht LVV-ja kritikë kryesore e ka pasur mos emërtimin dhe mos specififikimin e rrugëve se ku kanë për t'u përfunduar projektet, kështu që sinqerisht dhe pa ndikim politik, edhe pse e dimë që ka politikë në këtë mes, por meqë po e përmend dhe e kemi një model paraparak, parashtrova edhe këtë pyetje. **z. Fatlum Osmani**, drejtor i DBF-së, theksoi, ky është sqarim që vlen për të gjithë dhe tani mund të themi se unë nuk kam qenë asamblistë, por normalisht që angazhim politik kam pasur.

Shembull, tek kategoritë e mallrave po besoj që ka qenë gabim në të kaluarën ajo mungesë e specififikimit, ta zëmë specifikimi i ndërtimit të një rruge në fshatin Dumnicë ndërsa kanë mbetur rrugica pa u shtruar, rruga për në fshatin Dumnicë është e shtruar më parë, ose ta zëmë në një fshat tjetër bëhet fjalë për ndërtimin e rrugicave, projektet kryesore janë por në parim po e them që ai sqarim vlen për të gjithë, qoftë për LVV-në, qoftë për LDK-në, PDK-në dhe për gjitha subjektet tjera dhe në këtë kontekst sërish po e përsëris që ne jemi të emëruar politik dhe nuk bëhet fjalë këtu për buxhetin të cilin e ka bërë Fatlumi se a kalon apo jo, por është një dëm i cili i'u bëhet qytetarëve dhe normalisht edhe LVV-së kur nuk ka votuar sepse normale janë qëndrime politike që mbahen nga secili subjekt politik. Kur ka qeverisur LDK e ka pasur shumicën në assemble komunale deri me 29 nëntor 2020 dhe vota kundër nuk e ka pasur këtë pasojë që mund ta kemi tani sepse jemi në prag të zgjedhjeve lokale dhe këtë buxhet ka për ta marr qeverisja e ardhshme, pra jemi në një situatë specifike ku e vërteta është se në qeverisje është LVV-ja por shumicë në assemble komunale nuk është LVV-së, prandaj jemi pran një suate se a të kaloj ky projektbuxhet apo t'u shkaktohet një dëm qytetarëve të këtij vendi.

Edhe nëse se e marrim çdo propozim tuajin dhe nëse kalon, shembull kemi rritjen e buxhetit në arsim të cilin të gjithë e kanë mirëpritur, pastaj rritjen e buxhetit në kulturë po ashtu të gjithë e kanë mirëpritur sikurse rritjen e buxhetit në ekonomi, dhe tani në çoftë se kemi këto diskutime tek rrugët e fshatrave ose tek ndriçimi në rregull është, hiqen 30,000.00€ prej fshatit Lluzhan vendosen në fshatin Dumnicë ta zëmë. Pra në çoftë se nuk keni ndonjë mendim tjetër, nuk keni ku shkon përtej kësaj që po e them, por me këto diskutime për shuma 10,000.00€ ose 20,000.00€ aty këtu, pastaj po i humbim 2 milion euro, shumë kjo e cila është humbur si suficid në vitin e kaluar por që edhe këtë vit mund të ketë ndonjë problem kështu të

caktuar, mirëpo në çoftë se shkojnë suficid 2 milion euro, mund të kompensohen veç nëse i grumbullojmë për 3 vite 5 milion euro.

Do të thotë, kemi vetëm një pyetje, a dëshiron ndokush t'ia shkaktojmë këtë dëm qytetarëve të Podujevës e që besoj se nuk na kanë borxh që t'iu shkaktojmë dëme atyre.

z.Mehmet Gashi, theksoi, sa për dijeninë tuaj drejtor i DBF, në territorin e Komunës së Podujevës çdo rrugë që i ka mbi 50 metër gjatësi, është e regjistruar dhe e emërtuar, do të thotë kurrfarë problemi nuk ka pasur këtu. Pastaj edhe për projektet nëpër fshatra me i vendos emrat e fshatrave nuk ka kurrfarë problemi, qoftë edhe për ta bërë të veçantë një projekt është dashtë të specifikohen edhe rrugët të paktën apo vetëm fshati, do të thotë çdo rrugë është e emërtuar (me përjashtim të oborreve që disa i shtrojnë edhe nëpër oborre). Pra ne ju propozuam që t'i rekomandohet për mbledhjen e Kuvendit, dhe nuk potencuam asgjë kundër, vërejtjet që i thash kanë qenë me vend dhe mendoj që janë me vend, përndryshe Kuvendi vendos për projektbuxhetin, kurse ne këtu në KPF vetëm e trajtojmë paraprakisht.

z.Patriot Rudari, theksoi, unë vetëm pak po ndalem tek buxheti i këtij viti, shembull në fshatin Shajkoc prej nga vije unë, kanë qenë në projekte të planifikuara disa trotuare, kanalizime dhe ndriçim, do të thotë Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit është mirë ta arsyetoj këtë përse janë vonuar, edhe pse drejtori përkatës nuk qenka këtu prezent, unë po e them se është vonuar goxha shumë në krahasim me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit ose Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që kanë filluar projekte dhe i kanë përfunduar para 3 muajve, prandaj është pak keq që ende nuk kanë filluar ato projekte të Drejtorisë së cekur e që tani ndoshta ka qenë koha që të përfundojnë, andaj e ngrita këtë çështje edhe pse drejtori nuk është prezent për ta pyetur direkt por as në zyrë nuk po e gjejë, pra vetëm ta pyes pse nuk kanë filluar këto, ndriçimi ka ngecur në fshatin Shfeçël, nëse nuk gaboj trotuaret gjithashtu kanë ngecur. Nuk po dëshiroj të hyjë më shumë në këtë çështje me shpresën se projektet e cekura do të përfundojnë para zgjedhjeve.

Kryesues i Komitetit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës.

Njëzëri, me 8 vota Për (sa ishin prezent), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim propozim vendimi për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2023-2024, sipas thirrjes dhe materialit të dërguar për këtë pikë të rendit të ditës.

3. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, në bazë të Ligjit për tatimin në pronë, çdo institucion përkatësisht çdo Komunë duke u bazuar në minimumet dhe maksimumet të cilët i lejon Ligji për tatimin në pronë që rregullon normat tatimore për njësitë e pronave, edhe Komuna e Podujevës normalisht e ka këtë obligim që ta caktoj normat tatimore. Në propozimin e dërguar kemi caktuar minimumin, dhe thënë të drejtën, janë të njëjtat norma tatimore të cilat kanë qenë vitin e kaluar për këtë vit që jemi, dhe nuk kemi bërë ndonjë lëvizje normave tatimore që përjashtimisht për parcelat e objekteve komerciale që janë pak mbi minimumin, të tjerat janë nën minimum, do të thotë nuk mundemi të shkojmë më poshtë sa i përket normave tatimore bazuar në Ligjin përkatës, kështu që besoj se dokumentacionin përkatës e kemi marr me kohë dhe ju ftoj që ta rekomandoni si pikë të rendit të ditës për seancë Kuvendit të Komunës.

Njëzëri, me 8 vota Për, (sa ishin prezent), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022, sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar për këtë pikë të rendit të ditës.

4. Propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga taksa për ushtrimin e veprimtarive afariste

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, ndoshta një sqarim paraprak edhe pse çështja po shtrohet vetëm për propozim që t'i rekomandohet Kuvendit, por paraprakisht ndoshta kishte me qenë mirë që të gjitha subjektet ta kenë një sqarim nga ana jonë në rast se vetëm është e nevojshme. Këtu bëhet fjalë për taksat dhe për borxhet të cilët janë grumbulluar nga rregullorja për ushtrimin e veprimtarive afariste, kjo rregullore është ndryshuar para një kohe rreth dy-tre muaj, dhe janë anuluar / heqë të gjithë ato taksa dhe për ushtrimin e veprimtarisë, pra tani janë zero euro.

Borxhet janë grumbulluar nga viti 2002 kur vetëm ka filluar zbatimi i kësaj rregulloreje dhe problemi është që të gjitha këto borxhe rrjedhimisht janë pothuajse të pa mbledhshme, madje as përmes Gjykatës nuk mund të mblidhen për arsye se shumë nga këto borxhe janë parashkruar dhe është një numër i madh i subjekteve afariste që figurojnë në listat e borxhlinjve në Komunën e Podujevës dhe kjo po i shkakton probleme Komunës së Podujevës mënyrë të vazhdueshme sepse vazhdimisht janë vërejtje që jepen për llogaritë e arkëtushme të mëdha, ndërkohë që në anën tjetër këto janë borxhe fiktive si dhe në anën tjetër po u shkakton probleme bizneseve të cilat kryejnë procedura nëpër institucione të ndryshme e në veçanti në Banka me rastet e aplikimit për kredi ose diçka tjetër sepse nga bankat u kërkohet një dokument çoftë nga administrata tatimore, çoftë nga komuna që ata nuk kanë obligime tatimore ndaj institucioneve, prandaj në këtë rast Komuna pastaj po ndodhet në një pozicion jo të mirë sepse në njërin anë këto janë borxhe të pa mbledhshme kurse anën tjetër nuk mundemi të lëshojmë vërtetim që ai nuk ka borxhe tatimore, kështu që po penalizohen bizneset qoftë në fushën e biznesit të tyre qoftë në procedurat e prokurimit sepse ka ndonjë biznes i Podujevës ta zëmë konkurren për ndonjë tender në Prizren apo kudo tjetër, mirëpo edhe qasja në burimet financiare përkatësisht në kredit bankare po i penalizon bizneset në mënyrë të pa nevojshme për shkak të disa borxheve fiktive të cilat figurojnë në regjistrat e Komunës së Podujevës. Pra ka edhe disa komuna të cilat e kanë marr një vendim të tillë kështu që ne bashkërisht edhe me zyrën ligjore jemi bazuar në ato vendime dhe kemi gjetur një mundësi ligjore që të kalon si propozim vendim meqenëse për taksën e tillë komunale interpretimi ligjor është që mund ta falim si borxh, përndryshe po të ishte tatimi në pronë, ta zëmë, nuk mund të falet nga ana jonë si komunë sepse është e rregulluar me ligj, ndërkohë këto obligime dhe këto taksa janë të rregulluara me rregullore komunale, prandaj ju ftoj ta propozoni dhe rekomandoni për seancën e Kuvendit dhe njëkohësisht ta mbështesim pastaj si propozim vendim.

z.Mehmet Gashi, theksoi, e di dhe jam në rrjedha sa i përket kësaj pike, madje unë kam propozuar disa herë që të shqyrtohet çështja rreth faljes së borxheve të tilla meqenëse vërtetë është problematike, mirëpo problemi i vetëm për mua është se kjo është sjellë në kohë fushate zgjedhore e që ndoshta nuk është dashur të sjellët ky propozim vendim tani, por më herët ose të lihet pas zgjedhjeve, prandaj ky është paska si problem për mua, dhe tjetra që ndoshta po bëjmë të padrejtë ndaj atyre që kanë paguar këtë taksë edhe pse sa jam në dijeni është një numër i vogël që kanë paguar, kështu që ne në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së e rekomandojmë këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit edhe pse po e përsërisë se vetëm problemi është që është sjellë në kohë fushate dhe si rrjedhojë mund të përfitoj dikush prej kësaj e që nuk është gjë e mirë kjo. Përndryshe ne të gjithë jemi që t'iu ndihmohet bizneseve, andaj edhe e përkrahim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për 27 shtator 2021.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve LVV-së e përkrahë këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht i rekomandojmë Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së, theksoi, sa i përket kësaj pike e dëgjova drejtorin e DBF i cili e potencoj që bizneset borxhlinj apo të pa përgjegjshëm që unë i quaj ashtu sepse ne si shtet kemi pasur një falje të borxheve totale para disa viteve që e ka marr Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, por drejtori e potencoj se bizneset mund të aplikojnë për tender në Komunën e Prizrenit dhe pastaj po paraqet problem sepse del që ka borxhe në institucione, në këtë rast në Komunën e Podujevës, borxhi duhet të paguhet i nderuari drejtor. Çështja tjetër, ato biznese që e kanë paguar po i sanksionon me këtë vendim sepse këtyre tjerëve po jua falë, gjë për të cilën mendoj se askush nuk e ka të drejtën morale me ngrit dorën që ta obligoj dikë që është i përgjegjshëm (qoftë edhe nëse kanë ekzistuar 2 biznese), shumë i edukuar e i kulturuar dhe kontribuues për ta rritur buxhetin e Komunës duke i kryer të gjitha obligimet këtu kurse tjetri biznes është aq i pa përgjegjshëm (që nuk të bënë hesap fare) dhe ma ia falë ato borxhe. Këtu nuk kemi çfarë të flasim tjetër, nëse vjen dhe ankohet se nuk po mund ta marr një dokument sepse ka borxh edhe pse nuk po e di shumën maksimale të një borxhi të një biznesi të papërgjegjshëm që merr punë sërish prej kësaj komune, ai borxh nuk bënë të falet, jo pse është kohë fushate zgjedhore por edhe pa fushatë fare, madje po të ishte ky Kryetar i Komunës sot i vendosur, ato biznese duhet t'i disiplinohjme ngase mbushur me persona të tillë (kapadai) në këtë vend dhe me të tillë nuk po mund të shkojmë përpara. Kjo pikë e rendit të ditës për ata njerëz të papërgjegjshëm e di që edhe pa votën time, me votën shumicë të votave kalon ngase si njëjtë po funksionon ku pastaj duhet për të dalë me i vendos në faqe të Komunës vendimet tona si po dalin që po i marrim këtu, që Kuvendi Komunal mori vendim për falje të borxheve, andej e këndeje. Falje të borxhit kujt, për çfarë rastesh bëhet fjalë kinse janë ata persona që nuk vijnë ta paguajnë borxhin nga taksa komunale, a mund të ndodh që nëse hulumton në letra aty mund t'i gjesh se kanë marr përmbi 2 milion euro punë në Komunë, kurse nuk vijnë ta paguajnë taksën komunale ndërsa vijnë ankohen në zyre komunale që nuk po mund të marrin projekte ose tender në një komunë tjetër ngase po i'u figuron një taksë komunale 70 apo 40 € për tre muaj ta zëmë, kështu që për këtë arsye nuk bënë të falet ky borxh i tyre sepse nuk është borxh i pandemisë, nuk është borxh i bizneseve që janë shuar për shkak që ai e ka filluar e nuk ka pasur borxh.

Deri në seancën e Kuvendit mund t'i nxjerrësh drejtor emrat e bizneseve që janë mbyllur për shkak të mos punës e që i'u ka mbetur borxhi, klasifikoj dhe nxjerri ato që edhe pse nuk i kam shikuar specifikisht cilat biznese, sa është numri i tyre, sa është shuma e atyre borxheve ngase po ankohe mi për buxhet pastaj këtu ku po ka lloj lloj propozimesh siç ishte rasti i propozimit që t'jua japim nga 100 € nënave lehona por që ishte potencuar se nuk kemi buxhet, mandej është potencuar se nuk ka buxhet dhe është ankuar edhe Kryetari i Komunës kur ishte propozimi për t'iu ndihmuar njerëzve, madje Kryetari pati potencuar se ka borxhe që i kanë Komunës, kurse tani propozon t'iu falen borxhet. Jo të nderuar borxhi shtetëror/komunal duhet të mblidhet për tu rritur buxheti i shtetit dhe i komunës, pastaj siç e potencoj drejtori në pikën paraprake që duhet të rritet dhe të kaloj si buxhet sepse mbetet keq qytetari pastaj, mirëpo buxheti kalon kur ka transparencë, votën e opozitës e merr kur ka transparencë, nëse nuk e ke numrin tënd, nëse projektbuxheti 2022/2024 nuk kalon, është dashur që vërejtjet t'i merreni parasysht dhe t'i vendosni në letër.

Sa i përket asaj që e potencoj drejtori i DBF-së se nuk ka kapacitet të zë shkronjat për emërtimin e projekteve në rrugë dhe fshatra, atë diku tjetër thuaje drejtor jo këtu para nesh, letra i zë shkronjat mjaftueshëm, ashtu siç e ke shkruar rruga "Skënderbeu" apo "Xhemajl Mustafa" mund të shkruash edhe rrugët apo fshatrat tjera, madje unë vije dhe e vendosi. Nëse nuk i zë emrat e rrugëve qysh ka mund t'i zë emrat e mallrave dhe shërbimeve që i ke shkruar naftë/derivate për këtë apo atë, a do të thotë se ky dokument është tjetër, kurse ai është tjetër.

Çështja tjetër, projektbuxhet të Komunës, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk miraton, përveç nëse bënë budallallëk, nuk ka miratuar qe 20 vite, pra vetëm nëse ndokush bënë ndonjë budallallëk dhe në

këtë rast nuk po të drejtohem ty drejtor i DBF-së dhe mos keqkupto tani në këtë aspekt, mirëpo nëse edhe ti e bënë një gjë të tillë duhet të drejtohem edhe ty sepse ti je kompetenti ashtu siç nëse e bëjë unë gabim një gjë të tillë përgjegjësia mbetet tek unë, prandaj besoj se po kuptohem drejtë sepse unë i drejtohem pozitës e jo individit sepse këtu nganjëherë gjërat po keqkuptohen ngase kur po bëjmë vërejtje apo kritika në drejtim të ndokujt siç është në këtë rast drejtori z.Fatlum Osmani pastaj po mendojnë se janë personale e që asnjëherë nuk e bëjë një gjë të tillë, mirëpo nëse je kompetent dhe e ke vendos nënshkrimin aty në rregull është mendoj.

Shumë jam i bindur që këtë dokument kështu siç është LVV-ja nuk do ta kishte votuar po të ishte në opozitë, ndoshta ka ndonjë individ që do ta kishte votuar nuk po them që nuk kishte për të dalë ndokush prej tyre edhe pse ende nuk ka dalë që e kishte votuar kështu siç është sjell. Gjejeni projektbuxhetin e vitit 2019 dhe shikojeni si dokument që është sjellë nga ish drejtori z.Isuf Latifi dhe mund të vëreni se është kështu sikurse që është sjellë tani nga drejtori aktual i DBF-së, pastaj shikojeni vendimin e subjektit që i takon drejtori aktual dhe shikojeni përgjegjësinë ku ka mbetur qytetari që e ka votuar, prandaj kur bëhen këto gjëra duhet t'i thërrasësh Grupet parlamentare dhe të ketë konsulta rreth asaj se çfarë mendon secili. Unë kam lexuar këtë dokument dhe kam parë tek fshati im ku jetoj se janë disa planifikime tek disa individ, mirëpo të nderuar diferencimet politike kanë marr fund ato duhet të hiqen nga koka e secilit person dhe subjekt që vie në pushtet ngase jemi në shërbim të popullit/qytetarëve, andaj nuk bënë që një subjekt politik të thotë unë jam në pushtet dhe bëjë çfarë të dua dhe të bëjë krahasime politike sepse nuk e lejon tani më askush këtë lloj diferencimi politik sepse nuk mund të dalim jashtë rregullave dhe grumbullohemi këtu e diskutojmë për Podujevën, por kur të dalësh pak më lartë andej kufiri kemi mbetur të bllokuar, edhe pse ne po diskutojmë për buxhetin e Komunës së Podujevës dhe nuk po flasim për buxhetin që kemi mbetur të bllokuar në Jarinë e në Shtërrpc atje dhe nuk mund të lëvizë, nuk po diskutojmë as për Graqanicë, por po diskutoj për buxhetin dhe projektet që ndërlidhen me qytetarët e Komunës së Podujevës, pra kur pyes dua ta di shembull se cilat rrugë do të asfaltohen në fshatin Dyz, fundja po e jap kontributin që të kaloj ky buxhet ashtu siç thua ti drejtor, pastaj ti thua e kalova buxhetin sepse po punoj, në anën tjetër unë them se kaloj buxheti sepse ia japa votën për, që të shtrohet kjo rrugë ta zëmë në këtë apo atë lagje lagjen, mirëpo unë këtu sipas këtij dokumenti nuk po e di çka do të ndërtohet, cilat rrugë, cilin ndriçim e që në fshatin Dyz ndriçimi është dashur që të përfundoj, por ka ardhur dhe ka hyrë në diferencime politike, 52 vite lagjja "Llapashtica" në Dyz ka pasur diferencim politik, qoftë me Titon, qoftë me Rankoviçin, pastaj 21 vite diferencim politik me Shqiptar, ndërsa tani ai drejtor i Drejtorisë përkatëse vetëm dy rrugë i ka sepse ja heq dritat, e vendosi shkallën ja hjeku, po edhe nëse 8000 Policë të Republikës të vijnë aty apo edhe gjitha organet e shtetit, nuk do të mund të vendosen dritat aty nëse mendon ashtu në atë formë të zhvillonit projekte, ashtu nuk punohet.

Çështja tjetër, nëse ekziston mendimi që po fitohet pushteti, a jeni në dijeni se kur është më i rrezikuar ky vend, atëherë kur të shtrëngosh fort, asht siç mendonte Millosheviqi që unë jam "cari i ballkanit", prandaj këtu ka ndodhur diçka, kështu që për të bërë punë bashkëpunuese personalisht po e them jemi këtu për ta dhënë votën, por asnjëherë si opozitë dorën nuk e ngriti qoftë për të marrë fjalën qoftë për të votuar vetëm pse është në pushtet dikush tjetër sepse nuk kemi ardhur këtu për atë, fundja do të sihte mirë që ai që është në pushtet të ndalet në zyrë dhe të shikoj individët dhe të mendoj se vije ndokush këtu për 100-200 € të sillat rreth një seance, a është në hallë për bukë, jo nuk vije, mandej a vije ndokush të bëjë kalkulime politike duke u sjellë zyrave për të qenë pjesë e tenderëve dhe pushteteve jo, dhe kështu ndërlidhet edhe tek propozimi për faljen e borxheve, ju nuk e dini që në këtë komunë ka njerëz që kanë marr prona me qera dhe kanë borxhe deri në 80,000.00€ deri në 100,000.00€, mirëpo atë ditë që bëhet qytetari zot në shtet dhe që ai biznes të mund të funksionojë dhe të marr projekte me borxhe të tilla, kurrë në derë të mos vie, kushdo çoftë ai edhe në çoftë se jam unë sepse nuk ka dallime. Unë jam

në dijeni se mirë është të ndihmohen, por nuk janë të varfër, social apo të papunë këta që nuk kanë paguar borxhet, por këta i shohin vetën më zotëri sepse ju që jeni drejtor (i drejtohet drejtorit të DBF-së), mbaje mend këtë që po ta them, vetëm për këtë arsye kur dëshiron ndokush të paraqitet më zotëri se institucioni, i them vazhdo ti me tënden unë vazhdojë me timen. Sido që të jetë, dhe të gjitha borxhet me i falë, individualisht për mua është njëjtë, edhe të gjitha po t'i inkasoni sërish për mua është njëjtë, mirëpo ne po diskutojmë për drejtësi, për një vendim që e marrim të drejtë për një mos diferencim në mes atyre që kanë paguar rregullisht taksën dhe atij që nuk e ka trokitur derën kurrë për të paguar obligimet, në mes atij që e gjen një "postier" dhe vije këtu në Komunë dhe thotë vendose në rend dite se unë jua fali borxhet, në mes të atij që shikon se a kalon diçka me një votë apo gjysmë vote.

Ky debat ndoshta është i gjatë dhe i pa nevojshëm në vitin 2021 në institucione Shqiptare, mirëpo ne po e shohim që këtu gjithçka është në atë rrugë për momentin dhe fundja kjo më bëri të marrë fjalën sepse po e llogarisë me qenë personalisht unë në pozicionin e një biznesi që kam ardhur dhe i kam paguar taksat rregullisht, madje edhe është lavdëruar drejtori kur ka pasë 5% rritje të buxhetit në të kaluarën. **z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF-së, theksoi, i nderuari **z.Rafet Llapashtica** në fund është Kuvendi i Republikës së Kosovës ai i cili e voton buxhetin e konsoliduar të të gjitha organizatave buxhetore e që në këtë rast edhe Komuna e Podujevës është organizatë buxhetore. Në rast se nuk kalon këtu propozim buxheti, patjetër çdo miratim i buxhetit duhet të kalojë përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu ka ndodhur edhe në vitin e kaluar dhe është e rregulluar me ligj ashtu. Sa i takon çështjes së atyre borxheve, këtu po ju them kanë qenë borxhe dhe taksa fiktive që rrjedhimisht pjesa dërmuese e bizneseve as që janë të informuar që ekziston, në këtë rast me vendimin e asamblesë komunale në 2020 është larguar kjo taksë për një vit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuari drejtor i DBF-së, kur ta vendosësh letrën/dokumentin në ueb-faqe unë do të sjell kamerën dhe kam për t'iu thënë dëgjoni biznese, insistimi ka qenë për me i falë ata që nuk kanë paguar kurrë taksën e cekur, kurse ju që keni paguar rregullisht ndaluni në pasqyrë dhe shikojeni vetën ose mos paguani por gjejini një "postier" t'ua falë ose shikojeni çka merr vendim institucioni. Në Kuvend do t'jua jap votën, por edhe kanë për t'ju ardhur gazetarët në zyrë me pyetje konkrete dhe unë kam për ta ngritur kamerën para komune, e pastaj ai që ka paguar qe 20 vite këto obligime të mendojnë veprimet të tyre pse kanë paguar kur dikush nuk ka paguar, temë të cilën tani po e mbyllim sepse nuk ka sqarime, unë i kam të gjitha sqarimet dhe i personalisht i kam sqaruar por unë nuk mundem t'ua sqaroi gjithë Kuvendit që ata të mendojnë sikur Rafeti (unë), nuk tentoj kurrë, por nëse vije në Kuvend përfaqësuesi i popullit i ulur në karrige si qeverisje më ndryshe, unë aty qëndrimin njerëzor të dikujt nuk mund të ja jap sepse nuk i takoj atij rangu të njerëzve, dhe këtë po jua them sinqerisht ngase unë nuk sillem korridoreve dhe të shikoj se nga të votoj për një çështje të caktuar.

Dëgjo i nderuar drejtor, shumë pak personave do i'u vinte rendi këtu të bënin gjëra të tilla, sinqerisht po ju them, por tani me gjëra të tilla po bëhet politikë sepse fakt ne jemi përfaqësues të popullit të cilët në fushata zgjedhore po dalim po lypim vota në emër të përfaqësimit të drejtë, të mirë dhe në shërbim të tyre, por jo kështu. Kur do që dëshironi dalim para mediave me ju drejtor qoftë në TV Llapi qoftë kudo tjetër, japim konferencë dhe i japim deklaratat tona të cilave pastaj duhet t'iu qëndrojmë pas dhe të mos kthehemi më prapa.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, më 2020-2021 taksa në fjalë nuk ka ekzistuar sepse e ka larguar Kuvendi i Komunës, e vetmja mundësi është të inkasojmë borxhet e vitit 2019 sepse borxhet që janë më të vjetra se 3 vite ato parashkruhen dhe nuk mundesh me i marr as përmes Gjykatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ju drejtor i DBF-së e keni sjellë dhe vendos këtë temë në Kuvend të Komunës, në anën tjetër e potencuat se ky borxh është parashkruar, përkatësisht është heq, andaj nëse është ashtu çfarë ka të bëjë kjo me Kuvendin dhe përse e keni sjellë në Kuvend. Mos kështu se ne nuk jemi njerëz analfabet.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, e sqarova se çka janë mbi 3 vite as përmes Gjykatës nuk mund t'i inkasojmë, problemi është që vetëm mbetet borxh në letër asgjë më shumë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nëse nuk mund të inkasosh, të shkojnë dhe ta paguajnë borxhin ata persona për të cilët po thoni se ju është parashkruar, pastaj ekziston Ligji për parashkrim dhe përmes Gjykatës të thuhet se është parashkruar borxhi, prandaj pyes përse na ke sjell këtë pikë të rendit të ditës të debatojmë që gjysmë ore pa kurrfarë lidhje ngase nuk mund të flasësh për mjete financiare që kanë shkuar, nëse kanë borxhe është çështje tjetër a figurojnë në borxhet e Komunës ato pastaj dhe për këtë nuk mund të thuash që jo, ashtu siç është parashkruar (sipas jush), a figuron si borxh po, përse nuk i ke fshirë në sistem pasi që janë parashkruar, prandaj të sugjeroj të bisedosh me ndokën tjetër për këtë çështje por jo të bëni shaka me neve këtu.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka dikush çfarë të shtoj e hedh në votim se kush është që ti rekomandohet Kuvendit kjo pikë e rendit të ditës.

me 6 vota Për, asnjë votë kundër dhe 2 vota të përmbajtura, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

5. Informatë Drejtorisë së Arsimit për përgatitjet e vitit të ri shkollor 2021/2022

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, me që drejtori i DKA-së me arsyetim nuk është prezent i mbetet drejtorit të DBPZHR ta arsyetoj këtë pikë.

z.Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR-së, theksoi, pasi që drejtori i DKA-së kishte një takim urgjent, më autorizoj mua t'jua prezantoj këtë informatë e cila veç ju është përcjellë me kohë të gjithëve dhe keni mund ta lexoni dhe analizoni, andaj nuk kam çfarë të shtoj tjetër.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka ndokush diçka të shtoj rreth kësaj pike atëherë unë e hedh në votim se kush është që ti rekomandohet kuvendit.

Njëzëri, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

6. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z.Vigan Salihu, drejtor i DBPZHR-së, theksoi, unë kam për të raportuar edhe në mbledhjen e radhës së Kuvendit për këtë pikë të rendit të ditës, por nëse e shihni të arsyeshme po raportoj edhe këtu, mirëpo është e njëjta informatë dhe nuk kam diçka më shumë të shtoj rreth kësaj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush dëshiron ta marr fjalën ju ftoj ta merrni, nëse jo atëherë e hedh në votim që ti rekomandohet kuvendit për seancën e radhës.

Njëzëri, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

7. Propozim vendimi për vënie në shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2020-2028, me ndryshimet dhe plotësimet e hartuara nga DPUMM konform Vendimit nr.prot.01-450/05-0063175/21 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 30 korrik 2021

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, po vazhdojmë me pikën e 7 që u shtua si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë seancë, ftoj drejtorin e DPUMM nëse ka diçka të shtoj rreth kësaj.

z.Bujar Hasani, drejtor i DPUMM-së, theksoi, nuk kam çfarë të shtoj më shumë se sa që e paraqita në fillim të mbledhjes.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit.

Me 4 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 4 vota të Përmbajtura, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

(Dokumenti i Projekt Hartës Zonale - Pjesa Grafike dhe ajo Tekstuale, është i njëjti me atë i cili ju është shpërndarë në CD në mbledhjen e Kuvendit të Komunës më 13 korrik 2021)

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0084583/21
Podujevë,
24 shtator 2021**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**